

Vendim nr. 32 datë 20.02.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, në datën 20.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (H) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: HASAN ROQI

OBJEKTI: Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 231, datë 06.11.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 75 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); vendimi nr. 33, datë 08.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 16, datë 10.03.2016, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesën e paraqitur nga kërkuessit Skënder Roqi, Merjeme Roqi, Hasan Roqi, Luljeta Roqi, Santa Roqi dhe Kevin Roqi, duke shfuqizuar vendimin nr. 1736, datë 04.07.2014 të Kolegjtit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkesës, Gjykata ka vendosur rrëzimin e tyre.

2. Pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr. 00-2023-315, datë 01.02.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga rastet e parashikuara nga ligji.

3. Me kërkesën e datës 13.04.2023 kërkuessit Hasan Roqi, Fatbardha Perteçi, Luljeta Roqi dhe Santa Roqi i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, për të cilin, me vendimin nr. 138, datë 21.06.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

4. Pasi është njohur me këtë vendim kërkuessi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë, duke parashtruar pretendime si në lidhje me mënyrën e vlerësimit të kërkesës së tij nga Kolegji i Gjykatës, ashtu edhe për moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000 të Gjykatës Kushtetuese, që ka të bëjë me të drejtat e pretenduara për një pasuri të paluajtshme, shtëpi banimi.

5. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, duke konstatuar, fillimisht, se disa prej kërtimeve të kërkesës kanë të bëjnë me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit kushtetues, me vendimin e datës 06.11.2023 ka vendosur ndarjen e tyre dhe trajtimin administrativisht. Në lidhje me kërkimet e tjera në objektin e ankimit kushtetues individual Mbledhja e Gjyqtarëve ka vlerësuar se kërkesa është paraqitur në kuptim të nenit 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara ndonjërit prej rasteve të parashikuara nga kjo dispozitë, pra që të ketë të bëjë me gabime në shkrim, në llogari ose pasaktësi në vendimin nr. 138, datë 21.06.2023 të Kolegjit të Gjykatës. Po kështu, ajo ka vlerësuar se pretendimet e kërkuessit janë përsëritje e pretendimeve të paraqitura më parë prej tij dhe kanë të bëjnë në thelb me zbatueshmërinë dhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës nr. 76, datë 08.11.2000, si dhe me interpretimin dhe zbatimin e akteve ligjore në fuqi dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, që janë marrë në shqyrtim dhe u është dhënë përgjigje me vendimin e Kolegjit nr. 138, datë 21.06.2023.

6. Pasi është njohur me këtë vendim, në datën 23.01.2024 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e disa prej pikave të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkueti** ka kërkuar saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 231, datë 06.11.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, pa ndryshuar vendimin, në këto pjesë të tij:

7.1. *Pikat 1, 2 dhe 4 të rrethanave të çështjes.* Çështja e familjes Roqi ishte zgjidhur përfundimisht me ligj, njohje bashkëpronar, dhe me vendim përfundimtar në masën 37% të pjesës reale të pronës, një vit pasi vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë kishte marrë formë të prerë, pa pasur nevojë t'i drejtohen gjykatës. Por me ndërhyrjen e disa institucioneve, familja Roqi zvarritet prej 25 vjetësh në dyert e gjykatave edhe pse procesi i njohjes bashkëpronar dhe pjesa e caktuar prej 37% kishte përfunduar, duke mos u respektuar as ligji as vendimi gjyqësor përfundimtar. Kërkesa është fare e thjeshtë, respektimi i vendimit të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, që ndryshuan vendimin nr. 314, datë 11.04.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke njohur investimin e kërkuetit. Për më tepër, familja e kërkuetit ka nisur procesin e legalizimit dhe ka paguar tarifën përkatëse. Ata janë titullarë të së drejtës që buron nga zbatimi i drejtpërdrejtë i Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 21.06.1993 (*UKM nr. 3/1993*), e cila nuk është ndryshuar ose shfuqizuar. Gjykata ka dalë në shkelje të ligjit, që i ka dhënë familjes Roqi tagrin e bashkëpronarit në pjesën reale 37% të pronës. Kërkueti dhe familja e tij janë nxjerrë jashtë nga banesa nga grupe të strukturuar kriminale në administratë e gjykata.

7.2. *Pika 6 në rrethanat e çështjes.* Nuk ka njoftim për trupin gjyqësor që ka shqyrtuar çështjen në Kolegj dhe Mbledhjen e Gjyqtarëve, si dhe ditën e gjykimit, as me postë as me shpallje në faqen e Gjykatës, dhe as personalisht. Kjo është një metodë e ndryshme nga gjykatat e zakonshme dhe nuk është parashikuar nga ligji nr. 8577/2000 dhe Kodi i Procedurës Civile. Subjektet që paraqesin kërkesa në Gjykatë duhet të marrin njoftim rregullisht për çdo hap procedural. Në këtë mënyrë është shkelur e drejta e kërkuetit për t'u vënë në dijeni për përbërjen e trupit gjyqësor dhe ditën e gjykimit, në mënyrë që të kërkonte përjashtimin e disa anëtarëve, duke iu mohuar paanshmëria në gjykim. Në trupin gjyqësor kanë marrë pjesë 5 gjyqtarë për të cilët

ishte kërkuar përjashtimi, ndaj vendimi ka dalë me një pakicë prej 3 gjyqtarësh të paanshëm, që nuk përmbush kushtin për vendimmarrje.

- 7.3. *Pika 7 e vendimit*, pasi e drejta për shqyrtimin e ankimit për masë disiplinore të anëtarit të Gjykatës nuk i përket asaj, e cila e ka trajtuar veçmas dhe e ka arkivuar, çka përbën marrje kompetencash në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës që ia ka dhënë këtë kompetencë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) për periudhën tranzitore 9-vjeçare. Gjykata duhej të shpallte moskompetencën dhe ta rikthente kërkesën në KPA për shqyrtimin në themel. Vendimi nr. 2, datë 22.12.2023 i Kryetares së Gjykatës duhej të dilte para datës 25.04.2022, për moskompetencë, pasi në këtë rast vendimet nr. 138, datë 21.06.2023 dhe nr. 231, datë 06.11.2023 duken qartësisht të paragjykuara, me pasojë pavlefshmërinë e tyre. Këto veprime duhet të saktësohen dhe plotësohen në pikën 7 të vendimit nr. 231, datë 06.11.2023 si shkelje e rëndë procedurale.
- 7.4. *Pika 8.2. e vendimit*, duke korigjuar në fund të saj se vendimi nr. 76 i Gjykatës ka caktuar pjesën reale në pronë 37% për familjen Roqi dhe bashkëpronarë i ka bërë ligji dhe UKM-ja nr. 3/1993, i shkelur nga gjykata e ligjit dhe Gjykata.
- 7.5. *Pika 8.6. e vendimit*, pasi fjalia e tretë e saj ka fshehur korrupsionin në zyrën e regjistrimit. Në fjalinë e fundit të saj konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ për lëshimin e certifikatës së paligjshme të pronësisë duhet ta bënte, në radhë të parë, Gjykata e Lartë dhe më pas Kolegji me vendimin nr. 138, datë 21.06.2023.
- 7.6. *Pika 13 e vendimit*, pasi Gjykata ka vendosur të rrëzojë ligjin, UKM-në nr. 3/1993 që është themeli i kthimit dhe kompensimit të pronës, duke shkelur të drejtat e kërkuarit dhe Kushtetutën dhe duke marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave.
- 7.7. *Pika 14 e vendimit*, pasi ligji, UKM-ja nr. 3/1993 dhe vendimi nr. 76, datë 08.11.2000 i Gjykatës janë bërë objekt kontrolli nga vendimet nr. 138, datë 21.06.2023 dhe nr. 231, datë 06.11.2023 dhe janë shkelur pa asnjë arsye juridike, duke shkelur të drejtat e kërkuarit.
- 7.8. *Pika 15 e vendimit*, pasi përmendja e afatit 18-mujor është e pasaktë. Neni 27, pika 3, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se kërkesa drejtuar KPA-së, e cila shpalli moskompetencën, është marrë nga Gjykata prej KPA-ja pas dhënies së vendimeve nr. 2, datë 24.01.2022 dhe nr. 3, datë 25.01.2022. Kjo marrëdhënie kompetencash nuk i

përkiste kërkuesit, por Gjykatës dhe KPA-së. Gjykata kishte kohë të mjaftueshme, pasi kërkuesi ishte në mirëbesim, për të dalë me vendim, por preferoi të arkivojë kërkesën dhe t'ia hedhë fajin kërkuesit për tejkalim të afatit të paraqitjes së kërkesës, çka nuk është serioze dhe duhet të korrigjohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, rregullat e detajuara të procedurave të gjykimit kushtetues përcaktohen nga ligji nr. 8577/2000 dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (*Rregullorja*), të cilat kanë parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Në kuptim të këtyre parashikimeve, një prej rasteve në të cilin mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet saktësimi dhe plotësimi i vendimit me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80 i ligjit nr. 8577/2000*). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohen, por veçse mund të saktësohen, plotësohen ose ndreqen gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në to.

9. Kërkuesi, pasi është njohur me vendimin nr. 231, datë 06.11.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e atij vendimi, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se Gjykata ka marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave në një çështje ku vendimet gjyqësore kanë përfunduar që në vitin 2000 dhe kërkuesi e familja e tij janë shpallur bashkëpronarë sipas pikës 9, shkronja “ç”, të UKM-së nr. 3/1993, një vit pasi vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë ka marrë formë të prerë. Sipas kërkuesit, në këtë rast jemi përpara grabitjes së pronës dhe ai e familja e tij presin nga Gjykata që t'u rikthehet banesa, duke urdhëruar edhe regjistrimin e saj në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

10. Mbledhja e Gjyqtarëve, referuar objektit dhe shkaqeve të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, vëren se ajo nuk ka të bëjë me asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr.

8577/2000 dhe nenin 43 të Rregullores. Edhe në këtë rast, ashtu si edhe në kërkesën e mëparshme drejtuar Gjykatës, pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë, në thelb, me veprimet e institucioneve në lidhje me pasurinë në të cilën ai ka pretendime pronësie, ekzekutimin e vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si edhe me vendimet e Kolegjit të Gjykatës dhe Mbledhjes së Gjyqtarëve që kanë shqyrtuar kërkesat e tij, qoftë në drejtim të procedurës së ndjekur, përfshirë mënyrën e vlerësimit të pretendimeve të tij për paanshmërinë e disa gjyqtarëve, qoftë në drejtim të mënyrës se si janë vlerësuar shkaqet e parashtruara në ato kërkesa. Pretendimet e kërkuarit nuk kanë të bëjnë me gabime në shkrim, në llogari ose pasaktësi në vendimin nr. 231, datë 06.11.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Thelbi i pretendimeve në kërkesën në shqyrtim ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit nr. 138, datë 21.06.2023 të Kolegjit të Gjykatës, si në drejtim të përbërjes së tij, ashtu edhe në lidhje me mënyrën se si i ka trajtuar pretendimet e parashtruara nga kërkuari në kërkesën e datës 12.04.2023.

11. Pretendimet e kërkuarit janë përsëritje e pretendimeve të paraqitura prej tij në kërkesat e mëparshme drejtuar Gjykatës, të cilat janë marrë në shqyrtim dhe u është dhënë përgjigje me vendimin e Kolegjit nr. 138, datë 21.06.2023 dhe të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 231, datë 06.11.2023. Mënyra se si Kolegji dhe Mbledhja e Gjyqtarëve kanë vlerësuar dhe shqyrtuar çështjen, ashtu edhe procedura e ndjekur prej tyre në përputhje me parashikimet e ligjit organik dhe të Rregullores, nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë kësaj Gjykate, pasi edhe vendimmarrjet e dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak, nga Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve, kanë natyrë përfundimtare (*res judicata*).

12. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se për sa kohë vendimet e kësaj Gjykate nuk mund të bëhen objekt kontrolli ose rishikimi as nga vetë ajo, përveç rasteve të përcaktuara, në këtë rast, në mënyrë të shprehur në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000, dhe në kushtet kur kërkuari nuk ka argumentuar se ndodhet përpara ndonjërit prej këtyre rasteve, ai nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me kërkesën në shqyrtim.

13. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të risjellë në vëmendje të kërkuarit se paraqitja e kërkesave të tilla, për të njëjtat shkaqe dhe në thelb edhe për të njëjtin objekt, përbën premisë për zbatimin e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, që parashikon mundësinë e vendosjes së gjobës për abuzim me të drejtën për të paraqitur kërkesë.

14. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.